



With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



KATEDRA JEAN MONNET
EEAABAC

EU ENLARGEMENT AND ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES

SHKOLLA VERORE

Legjislacioni dhe institucionet e BE-së për profesionistët e së ardhmes

11 KORRIK – 15 KORRIK 2023

REFORMA NË PROKURIMET PUBLIKE NË KUADËR TË PËRAFRIMIT ME ACQUIS

Dr. Artan Spahiu – Dr. Aida Gace

Drejtor i Përgjithshëm i AKFAL – Lektore Dep Drejtes Uniel

Elbasan, 13.07.2023




Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

KATEDRA JEAN MONNET - EEAABAC - EU ENLARGEMENT and ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES



Historiku i Prokurimeve në Shqipëri



Historiku i Prokurimeve në Shqipëri

- ▶ Deri në vitet '90 nuk kishte ekonomi tregu në Shqipëri - koncepti i prokurimit publik nuk ekzistonte.
- ▶ VKM nr.400, date 17.11.1990 "Per blerjen dhe kryerjen e sherbimeve jashte sektorit shteteror" - akti i pare qe i hapi rrugen marredhenies shtet - privat. Ishte akoma shpejt per te folur per nje akt te mirefillte qe rregullonte prokurimin publik, por gjithsesi, nepermjet ketij akti iu dha mundesia ndermarrjeve shteterore te blinin nga kooperativat dhe privatet, mjete kryesore (ishte nje liste e limituar).
- ▶ VKM nr.191, date 22.03.1993 "Per sistemin e blerjeve publike dhe veprimtarine e blerjes dhe te sherbimeve qe kryejne ndermarrjet dhe institucionet qe financohen nga buxheti i shtetit" - hap i metejshem por akoma jo "prokurim publik".
- ▶ VKM nr.467, date 17.08.1993 "Per procedurat e prokurimit me fonde shteterore" – për herë të parë termi "prokurim publik".

Historiku i Prokurimeve në Shqipëri

- ▶ **Ligji nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", i ndryshuar**
 - Ligji Model i UNCITRAL-it për "Prokurimin e Mallrave dhe Ndërtimit/Punëve"** (1993) - Teksti i parë i zhvilluar nga UNCITRAL në fushën e prokurimit publik.
 - Ligji Model i UNCITRAL-it për "Prokurimin e Mallrave, Punëve dhe Shërbimeve"** (1994) - përfshinte edhe prokurimin e shërbimeve + ofroi një Udhëzues për miratim.
- ▶ **Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar**
 - Direktiva 2004/18/KE** e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 31 mars 2004, për "**Koordinimin e procedurave për shpalljen fituese të kontratave për punë publike, furnizime dhe shërbime publike**".
 - Direktiva 2004/17/KE** e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 31 mars 2004, për "**Koordinimin e procedurave të prokurimit të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në sektorët ujor, energjetik, të transportit dhe postar**".



Historiku i Prokurimeve në Shqipëri

► Ligji nr.162/2020 "Për prokurimin publik".

Ky ligj është përafuar pjesërisht me:

Direktivën 2014/24/BE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 26 shkurt 2014 "Për prokurimin publik dhe që shfuqizon Direktivën 2004/18/KE", e ndryshuar".

Direktivën 2014/25/BE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 26 shkurt 2014 "Për prokurimin nga entet që veprojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare dhe që shfuqizon Direktivën 2004/17/KE", e ndryshuar".

Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989 "Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike", e ndryshuar".

Direktivën e Këshillit 92/13/KEE, datë 25 shkurt 1992 "Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e rregullave të Komunitetit për procedurat e prokurimit të enteve që operojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe telekomunikacionit", e ndryshuar".



KUADRI LIGJOR I BE-SË PËR PROKURIMIN PUBLIK

Ne rastin e prokurimit publik, është e nevojshme të shikojmë:

- **Direktivat** e Prokurimit
 - **Dispozita të përgjithshme të Traktatit të Romës,**
 - **Parime të përgjithshme** të ligjit, të cilat udhëheqin interpretimin e Direktivave.
- Këtyre elementeve u referohemi bashkërisht si "legjislacioni *acquis* i BE-se".

Acquis communautaire – korpusi kumulativ i ligjeve të Komunitetit Evropian, që përfshin objektivat e KE-së, rregullat thelbësore, politikat dhe, në veçanti, legjislacionin primar dhe dytësor dhe praktikën gjyqësore – të gjitha këto janë pjesë e rendit juridik të Bashkimit Evropian (BE). Këtu përfshihen të gjitha traktatet, rregulloret dhe direktivat e miratuara nga institucionet evropiane, si dhe vendimet e përcaktuara nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë.

Acquis është dinamike, vazhdimisht në zhvillim pasi Komuniteti evoluon.

Të gjitha Shtetet Anëtare janë të detyruara të respektojnë *acquis communautaire*.

Termi përdoret më shpesh në lidhje me përgatitjet e vendeve kandidate për t'u anëtarësuar në Union. Ata duhet të miratojnë dhe zbatojnë të gjithë *acquis* për t'u lejuar të anëtarësohen në BE. Përveç ndryshimit të ligjeve kombëtare, kjo shpesh nënkupton ngritjen ose ndryshimin e organeve të nevojshme administrative ose gjyqësore që mbikëqyrin legjislacionin.



PARIMET BAZË TË PROKURIMIT PUBLIK

Nje nga objektivat kryesore te BE-se ka qene krijimi i nje tregu te perbashket qe eliminon pengesat per tregtine e mallrave dhe sherbimeve ndermjet shteteve anetare te BE-se.

Krijimi i nje tregu te perbashket prokurimi nenkupton heqjen e te gjitha pengesave ndaj tregtise qe krijohen ne nje kontekst prokurimi.

Pengesat ne tregti mund te ngrihen me ane te **legjislacionit** ose te masave te **autoriteteve kontraktore** ose **operatoreve ekonomike**.

-Legjislacioni mund te krijojte pengesa permes imponimit te kerkesave per “blerjen e produkteve vendase”.

-Autoritetet kontraktore mund te vendosin pengesa duke marre vendime diskriminuese ne lidhje me shpalljen e kontratave fituese.

-Edhe operoret ekonomike mund te krijojne pengesa duke bere marreveshje te fshehta se bashku per te ngritur vlerat e ofertave.



I. Traktati i Romës

Traktati i Romës i vitit 1957 (dhe traktatet pasues), nuk përfshin ndonjë dispozitë të shprehur qartë në lidhje me prokurimin publik.

Disa **parime themelore** mbi të cilat mbështetet BE-ja zbatohen në mënyrë të njëjtte edhe në fushën e prokurimit publik.

1. Ndalimi i diskriminimit mbi bazën e kombësive.

d.m.th. në një kontekst prokurimi, **nje operator ekonomik nga nje shtet anetar i BE-se, duhet te trajtohet ne te njejten menyre si nje operator ekonomik nga shteti anetar i autoritetit kontraktor.**

2. Levizja e lire e mallrave dhe heqja e kufizimeve sasiore për importet dhe eksportet dhe masat me të njëjtin efekt.

3. E drejta dhe liria e themelimit të një biznesi.

Ky parim është hartuar të **garantojë të drejtën e shtetasve të Komunitetit për të themeluar vetveten ose për të themeluar një agjenci, degë ose filial në territoret e shteteve të tjera anetare.**

4. E drejta për të ofruar shërbime.

Ky parim mbron të **drejtën e shtetasve nga shtetet anetare të vendosur në komunitet për të ofruar shërbime tregtare ose profesionale në territorin e shteteve të tjera anetare.**

II. Parimet e përgjithshme të se drejtes.

Praktika gjyqesore e Gjykatës Europiane të Drejtësisë (GJED), për zbatimin dhe interpretimin e së drejtës komunitare (“mbush boshllëqet”).

Zbatohen edhe në kontekstin e prokurimit publik.

1. Trajtimi i barabartë

Ky parim kërkon që **situatat identike të trajtohen në të njëjtën mënyrë ose që situatat e ndryshme të mos trajtohen në të njëjtën mënyrë.**

Nuk varet nga kombësia (si të parimi i mosdiskriminimit).

Trajtimi i ndryshëm i dy operatoreve ekonomike nga i njëjti shtet do të ishte trajtim i pabarabartë, por duke qenë me të njëjtën kombësi, nuk do të kishim diskriminim (mbi bazën e kombësisë).

2. Transparenca

Ky parim vendos mbi autoritetin kontraktor detyrimin e transparencës, i cili konsiston në **garantimin, në përfitim të çdo ofertuesi të mundshëm, të një niveli publikimi që është i mjaftueshëm për të mundësuar hapjen e tregut të shërbimeve ndaj konkurrencës dhe shqyrtimin e paansisë në procedurat e prokurimit.**

3. Njohja e perbashket

Ne praktike, kjo do te thote qe **shteti anetar ku ofrohet sherbimi duhet te pranoje specifikimet teknike, deshmite e kontrolleve, diplomat, certifikatat dhe kualifikimet e kerkuara ne nje shtet tjeter anetar, nese njihen si ekuivalente me ato qe kerkohen nga shteti anetar ne te cilin ofrohet sherbimi.**

4. Proporcionaliteti

Çdo mase e zgjedhur te jete e nevojshme dhe e pershtatshme, ne frymen e objektivave te kerkuara.

Ne zgjedhjen e masave qe duhen marre, nje shtet anetar i BE-se duhet te miratoje ato masa qe shkaktojne shqetesimin me te vogel te mundshem ne ecurine e nje aktiviteti ekonomik.

Ne rastin e autoriteteve kontraktore, duhet thene, per shembull, **se kur behet perzgjedhja e kandidatave ose ofertuesve, autoritetet kontraktore nuk duhet te imponojne kushte teknike, profesionale dhe financiare qe jane te tepruara dhe jo ne proporcion me objektin e kontrates.**

Parimet zbatohen ne menyre te pavarur nga Direktivat - **edhe kur nuk zbatohen Direktivat, parimet perseri mund te zbatohen - kontratat me vlere nen kufijte e ulet monetare nuk mbulohen nga Direktivat, por jane objekt i parimeve te pergjithshme.**

III. Direktivat e BE-së

Parimet e pergjithshme te ligjit **kane tendencen te jene negative ne permbajtje** - ndalojne sjelljen e papajtueshme - nuk japin udhezime.

Direktivat që mbulojnë rregullat procedurale

Ne sektorin publik – Direktivat mbulonin **punet, mallrat dhe sherbimet**.
Nuk perfshinin kontratat e dhena nga entet qe operonin ne sektoret e sherbimit te ujit, energjise, transportit ose telekomunikacioneve.

Nga viti 2004 - direktive te vecante ne **sektorin publik / sherbimeve**:

- Direktiva per sektorin publik - **Direktiva 2004/18/KE** - *Direktiva 2014/24/BE*
- Direktiva per sektorin e sherbimeve - **Direktiva 2004/17/KE** - *Direktiva 2014/25/BE*

Direktivat per mjetet/procedurat e ankimit

- Ne sektorin publik, mjetet/procedurat e ankimit rregullohen nga **Direktiva 89/665/KE**.
- Ne sektorin e sherbimeve publike, mjetet/procedurat e ankimit rregullohen nga **Direktiva 92/13/KE**.

Direktiva per perdorimin e formulareve standard ne publikimin e njoftimeve te kontratave publike (Direktiva 2001/78/KE)



Objekti i Direktivave procedurale

Direktivat synojne te **koordinojne procedurat kombetare per shpalljen e kontratave fituese**, duke prezantuar nje grup minimal rregullash te perbashketa procedurale.

Ne thelb, rregullat e perbashketa te Direktivave konsistojne ne zbatimin e parimeve baze te permendura me lart, sidomos per **mosdiskriminin, trajtimin e barabarte dhe transparencen** ne:

- publikimin e njoftimeve te kontratave te propozuara te prokurimit
- hartimin e specifikimeve teknike
- zgjedhjen e procedures se prokurimit
- kualifikimin dhe perzgjedhjen e kandidateve dhe te ofertuesve
- shpalljen e kontratave fituese.

Direktivat zbatohen vetem per kontratat e propozuara te prokurimit **qe kane nje vlere financiare mbi nje kufi monetar te percaktuar**.

Doktrina e GJED-se per “efektin e drejtperdrejte” - **individet mund te kerkojne per zbatim ne gjykatat kombetare te drejtat qe u jepen nga Direktivat**, kur plotesohen kushtet e duhura (per shtetet anetare).



1. Konkurrenca

Nga pikepamja ekonomike, “**konkurrenca**” funksionon si nje procedure **perzgjedhjeje** duke u lejuar operatoreve te ndryshem ekonomike te komunikojne cmimet me te cilat mallrat dhe sherbimet gjenden ne treg. Keto cmime sherbejne si udhezues dhe pasqyrojne kushtet e kerkeses dhe ofertes ne cdo moment.

- **Publikimi i njoftimit / Transparenca** - garantojne konkurrencen me te gjere te mundshme, duke u dhene mundesine operatoreve ekonomike nga i gjithë Komuniteti te komunikojne per cmimet e tyre me nje ent kontraktor te caktuar, duke siguruar keshtu zgjedhjen me te mire te mundshme.
- Zhvillimi i konkurrences se drejte (“terren i drejte”) perben nje problem kyc per arrijten e rezultateve ekonomike efikase ne prokurim.
- Legjislacioni per prokurimin kerkon te parandaloje cdo shtremberim ose kufizim te konkurrences.
- Ndalohet cdo perpjekje per t'i penguar operatoret ekonomike nga mundesia per te paraqitur ofertat e tyre.
- Mbrojtja e konkurrences eshte edhe ceshtje e ruajtjes se barazise se trajtimit.

2. Trajtimi i barabarte dhe mosdiskriminimi.

Çdo kusht kualifikimi me baze kombesine ose prejardhje lokale shkakton automatikisht trajtim te pabarabarte, pasi keto kushte, nga vete perkufizimi, diskriminojne nje grup te caktuar operatoresh ekonomike (te huaj) ose favorizojne nje tjetere.

- Diskriminimi prodhon trajtim te pabarabarte
- Trajtimi i pabarabarte jo gjithnje çon ne diskriminim.

3. Transparenca

Detyrimi i transparencës - garantimin, në përfitim të çdo ofertuesi të mundshëm, të një niveli publikimi që është i mjaftueshëm për të mundësuar hapjen e tregut të shërbimeve ndaj konkurrencës dhe shqyrtimin e paansisë në procedurat e prokurimit.

“Niveli i kërkuar i publikimit” shpesh varet nga shteti anetar në fjale, sidomos kur ka dispozita që rregullojnë kontratat për blerje në vlera të vogla.

Konsiderohet si një **mjet** për përmbushjen e objektivave të tjera.

- Publikimi dhe mundësia e aksesit në legjislacionin garanton qartësi dhe siguri për të gjitha grupet e interesit dhe u jep mundësi të jehë të vetedijshëm për rregullat e lojës (**trajtimi i barabartë**).
- Publikimi i njoftimit garanton transparencë në procesin e përzgjedhjes, d.m.th. garantojnë **konkurrencën më të gjërë të mundshme**.
- Publikimi paraprak i specifikimeve teknike, i kriterëve të përzgjedhjes dhe shpalljes së fituesit u lejon grupeve të interesit të verifikojnë që ato janë të drejta dhe **jodiskriminuese**.
- Transparenca është një aspekt themelor i **“llogaridhënies”**, d.m.th. t’i vëre specialistet e prokurimeve para përgjegjësisë për vendimet dhe veprimet e tyre. “llogaridhënia” është edhe një objektivi i qartë i sistemeve kombëtare të prokurimit.

4. *Ekonomia dhe efikasiteti*

Ky eshte nje parim qe shpesh perdoret per te pershkruar efikasitetin teknik te vete procedures, d.m.th.

- nese planifikimi ka qene i sakte dhe ne kohe;
- nese jane angazhuar pergjegjesi te ndryshme;
- nese u eshte dhene kohe e mjaftueshme operatoreve ekonomike per te pergatitur ofertat e duhura;
- nese prokurimi eshte bere ne kohen e duhur.

Ne nivel me "ekonomik", parimi perdoret edhe per te pare nese jane perdorur strategji kontraktore te sakta ose nga me te mirat, per minimizimin e shperdorimeve dhe per te perfituar nga ekonomite e shkalles.

Ne nivel politikash, parimi mund te perdoret per te analizuar efikasitetin e shperndarjes se transaksioneve dhe te sistemit si nje i tere, per te percaktuar nese kjo mund te permiresohet me tej.

5. *Vlera per parate*

Vlera per parate eshte nje term me perkufizim te gjere qe perdoret kryesisht ne vendet anglo-saksone.

Mbivendoset me konceptet e ekonomise dhe efikasitetit, me qellim qe **procedura e prokurimit te kryhet me humbje sa me te vogla (ne lidhje me koston dhe kohen) dhe me sa me shume perfitim qe te jete e mundur.**

Kushti baze eshte qe **qeveria te bleje vetem ato qe i nevojiten realisht.**

Ndersa i takon autoritetit kontraktor te vendose se cfare te bleje, problemi eshte se specifikimet duhet t'u pergjigjen nevojave reale te autoritetit kontraktor.

Vlera per parate - autoritetet kontraktore duhet te blejne kombinimin optimal te karakteristikave qe plotesojne nevojat e tyre.

Cilesia, jetegjatesia, qendrueshmeria etj. e produkteve te ndryshme ne oferte do te matet kundrejt koston se tyre.

Mund te jete e preferueshme te paguhet me shume per nje produkt qe ka kosto te ulet mirembajtjeje, sesa per nje produkt me te lire, i cili ka kosto me te larte mirembajtjeje.

6. Ndershmeria ose integriteti

Legjislacioni i prokurimit redukton mundesite per praktika korruptive.

Duke imponuar kerkesat e llogaridhenies dhe te transparences ne menyren qe aktiviteti i specialisteve te prokurimeve te mund te kontrollohet dhe verifikohet

Vendimet e tyre regjistrohen dhe me vone mund te verifikohen qofte nga qeveria (auditi i brendshem ose i jashtem), qofte nga operatoret ekonomike te demtuar.

Disa ligje kombetare e perdorin ndershmerine dhe integritetin si nje objektiv te shprehur qarte.

Fusin ne legjislacionin kombetar klauzola shtese te natyres praktike qe kerkojne te zbatojne ndershmerine (p.sh. dispozitat mbi konfliktin e interesit), se bashku me dispozitat vijuese qe trajtojne masat qe duhen marre kur konstatohet ekzistenca e praktikave korruptive.

Gjithashtu parashikohet se denimet e meparshme per praktika korruptive mund te cojne ne skualifikim automatik nga procedura e prokurimit.

SHQIPËRIA

Detyrimi i përafrit të legjislacionit të prokurimit publik me ato të BE-se.

Detyrimi për të përafuar plotësisht legjislacionin shqiptar të prokurimit me direktiven respektive është i shtirë në kohë.

Vinte nga një ligj model UNICITRAL - transpozimi i direktives të mos ishte i menjehershëm pasi autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë do ta kishin të vështirë përshatjen.

Përafrit i shkallëzuar i direktives në legjislacionin Shqiptar.

Nënshkrimi i marrëveshjes së stabilizim-asociimit në 12 qershor 2006 - hyri në fuqi në vitin 2010 – kërkonte përafrit të legjislacionit të prokurimit.

Në samitin e 24 Marsit 2020 u mor vendimi i hapjes së negociatave me Shqipërinë dhe Maqedonin e Veriut.

Kapitujt e Acquis - 35.

Prokurimi Publik – kapitulli 5.



SHQIPËRIA

Legjislacioni shqiptar në një masë të madhe i përafruar me Acquis e BE

PROKURIMI PUBLIK - rëndësi madhore.

Kapitulli 5 bën pjesë në Grupin 1 “Themeloret”, përkrah kapitujve të tjerë të rëndësishëm si Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”, Kapitulli 24 “Drejtësia, Liria dhe Siguria”, Kapitulli 12 “Kontrolli financiar”, Kapitulli 18 “Statistikat”, etj.

Miratimi i një Strategjie kombëtare për prokurimin publik, e cila është e harmonizuar me Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike - rekomandim kyç i Raporteve të KE.

Në Raportin e KE për vitin 2022 theksohet se **Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në prokurimet publike. Përparim i mirë:**

- vijim i procesit të miratimit të legjislacionit dytësor në zbatim të ligjit të ri,
- zhvillimit dhe implementimit të kurseve të trajnimit,
- vendosjen e “të dhënave të hapura”/open data në kohë reale për procedurat e prokurimit;
- përfshirjes së **risqeve të korrupsionit të lidhura me prokurimin** në planet e integritetit të institucioneve.



PROKURIMET PUBLIKE VS GDP

Shqipëria: Sipas analizës vjetore të vitit 2022, rezulton se, për vitin 2022 fondi total limit i publikuar zë **9.4%** të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB). Gjatë vitit 2022 ka një ritje të raportit të fondit total limit me PBB krahasuar me vitin 2021 kur ky raport ishte **8.9%**



Prokurimet Publike-Baza Ligjore

- Ligji nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”
- VKM 285, datë 19.05.2021 Për rregullat e Prokurimit Publik.

Neni 3

Parime të përgjithshme

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë **trajtim të barabartë** dhe **jodiskriminues** për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me **transparencë** e në mënyrë **proporcionale**.

Parimet janë të lidhura me njëri-tjetrin - mund të shkaktojnë efektin “domino” - nëse nuk respektohet njëri prej tyre, kjo çon në mosrespektimin e një prej parimeve të tjera, e kështu me radhë.

I. Prokurimet - Përkufizime

Cfarë është prokurimi?

Blerja e punëve, furnizimi i mallrave ose shërbimeve nëpërmjet një kontrate publike nga ana e një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore nga operatorët ekonomikë që zgjidhen nga këto autoritete ose ente kontraktore, pavarësisht nëse punët, furnizimet e mallrave ose shërbimet përdoren ose jo për qëllime publike .



Prokurimet - Përkufizime

With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



Autoritet kontraktor:

“Autoritet kontraktor” është çdo ent që i nënshtrohet këtij ligji për zbatimin e kontratave të tij publike. Këto ente janë:

- a) institucionet kushtetuese, institucionet e tjera qendrore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- b) çdo ent:
 - i. i themeluar për të ndjekur një interes të përgjithshëm dhe me karakter joekonomik apo tregtar;
 - ii. i cili ka personalitet juridik;
 - iii. i financuar kryesisht nga shteti, autoritetet rajonale apo vendore ose nga ente të tjera publike apo i administruar prej tyre ose me një bord administrativ, menaxherial apo mbikëqyrës, ku më shumë se gjysma e anëtarëve të tyre emërohen nga shteti, autoritetet rajonale ose vendore apo nga entet e tjera publike;
- c) organizatat e formuara nga një ose disa nga këto autoritete apo nga një ose disa nga këto organe publike.



“Entet kontraktore” janë:

a) autoritete kontraktore ose sipërmarrje publike, që kryejnë një nga veprimtaritë e përmendura në nenet 60 deri në 66 të këtij ligji;

- veprimtaritë në sektorin e gazit dhe ngrohjes
- veprimtaritë në sektorin e energjisë elektrike
- veprimtaritë në sektorin e ujit, trajtimin e ujërave të zeza
- veprimtaritë në fushën e transportit nëpërmjet hekurudhave, sistemeve automatike, tramvajit, trolejbusëve, autobusëve ose teleferikëve
- veprimtaritë që lidhen me shfrytëzimin e aeroporti, porti detar, terminaleve për mjetet e transportit ajror, detar ose mjete të transportit ujor të brendshëm.
- veprimtaritë që lidhen me ofrimin e shërbimeve postare
- veprimtaritë që lidhen me nxjerrjes së naftës, gazit, qymyrit dhe lëndëve djegëse të ngurta

b) ente, të cilat nuk janë autoritete kontraktore ose sipërmarrje publike sipas shkronjës “a”, por kanë si veprimtari të tyre një nga veprimtaritë e përmendura më sipër, ose çdo kombinim të tyre dhe funksionojnë mbi bazën e të drejtave të veçanta ose ekskluzive, të dhëna nga një autoritet kompetent.

“Fondet publike” janë:

- a) çdo vlerë monetare e **buxhetit të shtetit**, e përcaktuar për përdorim në prokurimet publike;
- b) çdo vlerë monetare e **buxhetit vendor**, e përcaktuar për përdorim në prokurimet publike;
- c) **fonde ndihme ose kredi, të dhëna nga donatorë të huaj**, sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare, në të cilën kërkohet zbatimi i procedurave të këtij ligji;
- ç) **të ardhurat** nga shteti, ndërmarrjet lokale, shoqëritë tregtare dhe entet e tjera, ku shteti zotëron shumicën e aksioneve ose të kapitalit.

Prokurimet - Përkufizime

- **“Kontratat publike”** janë kontratat me shpërblim, të lidhura me shkrim, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore, që kanë si objekt kryerjen e punimeve, furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, në përputhje me këtë ligj.
- **“Kontrata të sektorit klasik”** janë kontrata publike të lidhura ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve kontraktore, duke përjashtuar ato që janë kontrata sektoriale.
- **“Kontratat sektoriale”** janë kontrata publike, të lidhura nga entet kontraktore, që veprojnë në sektorët e shërbimit ujor, energjetik, të transportit dhe atij postar, ndërmjet një ose më shumë operatorëve ekonomikë, që kanë si qëllim kryerjen e veprimtarive, në këta sektorë.
- **“Kontratat e konsulencës”** janë kontratat publike për shërbime konsulence, të një natyre intelektuale dhe këshilluese, duke përjashtuar llojet e tjera të shërbimeve, ku mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë.



PROKURIMET - PËRKUFIZIME

With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



- **“Kontrata publike furnizimi”** janë kontratat publike, që kanë objekt blerjen, blerjen me pjesë ose me këste, qiranë me ose pa mundësi blerjeje të mallrave. Një kontratë publike furnizimi mund të përfshijë në mënyrë dytësore edhe vendosjen edhe instalimin.
- **“Kontrata publike për punë”** janë kontratat publike që kanë si objekt të tyre:
 - a) kryerjen ose projektimin dhe kryerjen e punëve në lidhje me një ose më tepër aktivitete ndërtimore;
 - b) realizimin ose projektimin dhe realizimin e një pune;
 - c) realizimin me anë të çdo mjeti të një pune, që përkon me kërkesat e specifikuara nga autoriteti kontraktor që ushtron një ndikim vendimtar në llojin ose projektin e punës.
- **“Kontratat publike për shërbime”** janë kontratat publike, që kanë objekt kryerjen e shërbimeve, të ndryshme nga “punët”.
- **Kontratat e përziera** - Kontratat, që kanë si objekt të tyre dy ose më shumë lloje prokurimi për punë, shërbime ose furnizime - sipas llojit të prokurimit që karakterizon objektin kryesor të kontratës në fjalë.



PROKURIMET - PËRKUFIZIME

- **“Konkurse projektimi”**, janë ato procedura që i mundësojnë autoritetit ose entit kontraktor që të blejë, kryesisht, në fushat e planifikimit urban dhe rural, arkitekturës dhe inxhinierisë ose përpunimit të të dhënave një plan ose projekt të përzgjedhur nga një juri, pasi është futur në konkurs me ose pa dhënie çmimi.
- **“Marrëveshje kuadër”** është një marrëveshje ndërmjet një apo më shumë autoriteteve dhe një a më shumë operatorëve ekonomikë, qëllimi i së cilës është të vendosë kushtet e kontratave, që do të prokurohen gjatë një periudhe të caktuar kohore, veçanërisht ato që kanë lidhje me çmimin dhe, aty ku është e përshtatshme, me sasisë e parashikuara (jo më gjatë se 4 vjet dhe 8 vjet sektorialet).
- **“Ofertues”** është operatori ekonomik, që paraqet një ofertë në një prokurim publik.
- **“Operator ekonomik”** është çdo person fizik ose juridik, ose ent publik apo grup personash/entesh, përfshirë shoqëritë me sipërmarrje të përkohshme të tyre.

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë **trajtim të barabartë** dhe **jodiskriminues** për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me **transparencë** e në **mënyrë proporcionale**.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore **nuk duhet** të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose **të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën**. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në **legjislacionin mjedisor, social e të punës** dhe në dispozitat e **marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare**, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën



KONTRATA NDËRMJET SUBJEKTEVE BRENDA SEKTORIT PUBLIK

With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



Autoriteti ose enti kontraktor mund t'i japë një kontratë publike një personi juridik që rregullohet nga e drejta private ose publike, **duke mos zbatuar dispozitat e këtij ligji**, kur janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) **autoriteti ose enti kontraktor ushtron mbi personin juridik kontroll**, i cili është i ngjashëm me atë që ushtron mbi departamentet e veta, ku më shumë se 80% e aktiviteteve të personit juridik të kontrolluar kryhen në zbatim të detyrave që i janë besuar nga autoriteti kontraktor kontrollues ose nga persona të tjerë juridikë që kontrollohen nga ai autoritet kontraktor;

b) **Nuk ka pjesëmarrje të drejtpërdrejtë me kapital privat në personin juridik të kontrolluar, por, edhe nëse ka, atëherë kjo pjesëmarrje nuk duhet të ketë kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij dhe nuk duhet të ushtrojë një ndikim vendimtar mbi personin juridik të kontrolluar sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.** Një autoritet ose ent kontraktor konsiderohet se ushtron mbi një person juridik një kontroll të ngjashëm me atë që ai ushtron mbi departamentet e tij sipas kuptimit të shkronjës “a” të kësaj pike, në rastet kur ai ushtron një ndikim vendimtar si në objektivat strategjike, ashtu edhe në vendimet e rëndësishme të personit juridik të kontrolluar. Ky kontroll mund të ushtrohet edhe nga një person juridik tjetër, i cili në vetvete kontrollohet në të njëjtën mënyrë nga ky autoritet ose ent kontraktor.





Mbrojtja e integritetit të procedurës dhe masat e përgjithshme për parandalimin e korrupsionit

With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



1. Prokurimi publik duhet të zhvillohet në mënyrë transparente me paanshmëri dhe pa asnjë trajtim preferencial.
2. Procedurat e prokurimit duhet të kërkojnë standardet më të larta të etikës dhe besimit publik.
3. Punonjësit e autoritetit, të angazhuar në përgatitjen e dokumenteve të tenderit nuk mund të jenë ofertues.
4. Autoritetet duhet të marrin masat e përshtatshme për të parandaluar, identifikuar dhe zgjidhur rastet e konfliktit të interes, për të shmangur shtrembërimin e konkurrencës dhe për të garantuar trajtimin e barabartë të të gjithë operatorëve ekonomikë.
5. Autoriteti refuzon një ofertë nëse: a) ofertuesi i jep ose premtun t'i japë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një zyrtari apo punonjësi një shpërblim në çfarëdolloj forme, b) ofertuesi është në kushtet e konfliktit të interesit;





Institucionet që garantojnë sistemin

With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



1. Agjencia e Prokurimit Publik

- Mbikëqyr sistemin e prokurimit publik, me qëllim sigurimin e efikasitetit dhe transparencës në procesin e prokurimit publik;
- Nxjerr vendime, udhëzime dhe rekomandime;
- Miraton me vendim dokumentet standarde të tenderit;
- Jep këshilla dhe asistencë në fushën e prokurimit publik;
- Verifikon zbatimin e ligjshmërisë së procedurave të prokurimit;
- Monitoron zbatimin e kontratave;
- Në rast shkeljesh të ligjit, vendos gjoba;
- Përrjashton një operator ekonomik nga e drejta për të përfituar kontrata publike;
- Menaxhon bazën e të dhënave të procedurave të prokurimit;
- Harton dhe publikon Buletinin e Njoftimeve Publike;





Institucionet që garantojnë sistemin

With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



2. Komisioni i Prokurimit Publik

Është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit;

Merr vendime për ankesat e paraqitura para tij; Vendimet janë administrativisht përfundimtare dhe mund të ankimohen në Gjykatën Administrative të Apelit.

Nxjerr interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, të cilat zbatohen për sa janë të vlefshme në vendimmarrjet e ardhshme.

Në marrjen e vendimeve mban parasysh parimet e mëposhtme:

- paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave,
- qëndrueshmërinë në vendimmarrje,
- ligjshmërinë,
- shpejtësinë dhe efikasitetin,
- aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit.



Kufijtë monetarë:

1. Kufiri i lartë monetar:

650.000.000 lekë - për kontratat e punëve publike;

40.000.000 lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe të mallrave.

2. Kufiri i ulët monetar:

12.000.000 lekë - për kontratat e punëve publike;

10.000.000 lekë - për kontratat publike të shërbimeve dhe të mallrave.

3. Kufiri monetar për prokurime me vlerë të vogël:

Për prokurimet, vlera e përlogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, është nga 100.000 – 1.000.000 lekë - procedura prokurim me vlerë të vogël.

Për objektet, ku përfshihen mallra dhe shërbime të ngjashme, vlera e përlogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, nuk është më e madhe se 100.000 lekë, autoriteti kontraktor nuk i nënshtrohet procedurave të prokurimit.



Kriteret detyruese për skualifikim

With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



OE që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale

OE ka shkelur detyrimet për pagesën e taksave ose të sigurimeve shoqërore;

Ka shkelje të legjislacionit për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha;

OE ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit;

Është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale;

OE ka lidhur marrëveshje me OE të tjerë që të shtrembërojnë konkurrencën;

OE ndodhet në kushtet e konfliktit të interes;

OE është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti;

OE ka paraqitur deklaratë të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar;



Kërkesat për kualifikim

Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet.

Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në **ofertën ekonomikisht më të favorshme**.
2. Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e **efektivitetit të kostos**, dhe mund të bazohet në **raportin më të mirë çmim-cilësi**, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës.

Kritere të tilla mund të përfshijnë:

- a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore;
- b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën; ose
- c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit;

Elementi i kostos, gjithashtu, mund të marrë formën e një çmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e të cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm për kriteret e cilësisë.

Njoftimi i fituesit

Menjëherë, por jo më vonë se 5 ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti kontraktor publikon në sistemin e prokurimit elektronik njoftimin e fituesit.

Me publikimin e njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik, operatorëve ekonomikë i lind e drejta e ankimit.

Periudha e pritjes

Autoriteti ose enti kontraktor nuk mund të nënshkruajë kontratën me fituesin e procedurës së prokurimit pa kaluar një periudhë e caktuar nga dita e publikimit të njoftimit të fituesit, si më poshtë:

- a) të paktën 10 ditë kalendarike, në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;
- b) të paktën 7 ditë kalendarike, në rastin e procedurave të prokurimit nën kufirin e lartë monetar;
- c) të paktën 2 ditë kalendarike në rastin e prokurimeve me vlerë të vogël.



Afatet për ankim dhe vendimarrje

With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda **10 ditëve** nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është **7 ditë**.

2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda **10 ditëve** nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është **7 ditë**.

Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në **autoritetin kontraktor** dhe **Komisionin e Prokurimit Publik**.

Për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, KPP merr vendim jo më vonë se **30 ditë** pas marrjes së informacionit apo dokumentacionit nga autoriteti ose enti kontraktor.

Për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është jo më vonë se **20 ditë**.





Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik

With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



Përpara lidhjes së kontratës, KPP ka të drejtë:

- a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj;
- b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;
- c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;
- ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes;





Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik

With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



Pas lidhjes së kontratës,

KPP, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit ose entit kontraktor është në kundërshtim me ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë:

- a) të deklarojë **absolutisht të pavlefshme kontratën** e nënshkruar, në përputhje me parashikimet e këtij ligji;
- b) të urdhërojë autoritetin kontraktor për shkurtimin e kohëzgjatjes së kontratës dhe të kërkojë ndërprerjen e parakohshme të saj;
- c) të marrë një vendim deklarativ, në bazë të të cilit pushteti gjyqësor mund të dëmshpërblejë ankuesin, që ka pësuar humbje ose dëme si rezultat i shkeljes së këtij ligji.



Pavlefshmëria e kontratave

Një kontratë do të konsiderohet absolutisht e pavlefshme në rastet e mëposhtme:

- a) nëse një autoritet ose ent kontraktor ka nënshkruar një kontratë pa publikuar paraprakisht shpalljen e njoftimit të kontratës;
- b) kur nuk janë zbatuar parashikimet e këtij ligji në lidhje me zbatimin e procedurave të ankimit, duke privuar personat e interesuar për të ushtruar të drejtën e tyre për ankim;
- c) kur nuk janë zbatuar rregullat për rihapjen e garës për kontratat e lidhura në bazë të një marrëveshjeje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara dhe në sistemin dinamik të blerjeve të ndarë në kategori;
- ç) kur kontrata është nënshkruar në kushtet e konfliktit të interesit;
- d) Nëse një autoritet ose ent kontraktor ka nënshkruar një kontratë duke mos respektuar vendimin e dhënë nga KPP.



Llojet e procedurave të prokurimit publik janë:

With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



1. procedurë e hapur;
2. procedurë e kufizuar;
3. procedurë konkurruese me negociim, e cila përdoret vetëm në rastin e kontratave të sektorit klasik;
4. partneritet për inovacion;
5. dialogu konkurrues;
6. procedurë me negociim me shpallje paraprake të njoftimit, e cila përdoret vetëm në rastin e kontratave sektoriale;
7. procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës;
8. procedurë e hapur e thjeshtuar;
9. shërbim konsulence.
10. prokurimet me vlerë të vogël.





RISITË E LIGJIT 162/2020/ PËRAFRIMI ME AQCUIS

With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



- Qartësim i fushës së zbatimit të ligjit, përjashtimet specifike dhe kontrata të përziera të prokurimit;
- Parashikimi për herë të parë i konceptit të kontratave të rezervuara dhe kontratave ndërmjet subjekteve brenda sektorit publik;
- Parashikimi i njoftimeve paraprake dhe periodike të informacionit, si mjete që rrisin transparencën, dhe i japin mundësi operatorëve ekonomikë të njihen kohë më parë me të dhënat e një objekti konkret prokurimi të planifikuar;
- Projektligji përcakton kufij të ulët dhe të lartë monetar, ku për të gjitha procedurat mbi kufirin e lartë monetar ruhen parashikimet e direktivës, ndërkohë që parashikohen afate më të shkurtuara për procedurat nën këtë kufij, pra për procedurat kombëtare;
- Parashikimi i procedurave të prokurimit, sipas direktivave përkatëse të BE-së, duke parashikuar procedura të reja prokurimi, me faza, siç janë: procedura konkurruese me negociim, dialogu konkurrues dhe partneriteti për inovacion;
- Procedura më të thjeshtuara në prokurimin e veprimtarive të sektorit sektoral.





RISITË E LIGJIT 162/2020/ PËRAFRIMI ME AQCUIS

With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



- Projektligji trajton në tërësinë e tij, si prokurimin e sektorit klasik, ashtu edhe atij sektoral, me përcaktime në nenet që vlejné për të dy sektorët, si dhe një kre të posaçëm, me rregullime specifike për sektorin sektoral (i cili, përfshin veprimtari që kanë të bëjnë me shërbimet e transportit, ujit, energjisë, gazit, shërbimet postare, portet dhe aeroportet);
- Lehtësimi i pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nëpërmjet përdorimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treat;
- Parashikimi i përdorimit të kriterit për vlerësim “oferta ekonomikisht më e favorshme”, e cila identifikohet në bazë të çmimit dhe kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos;
- Paraqitja e sigurimit të ofertës, si një masë mbrojtëse për autoritetet kontraktore, në rast të tërheqjes së ofertuesit;





RISITË E LIGJIT 162/2020/ PËRAFRIMI ME AQCUIS

With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



- Në referim të parashikimeve në direktivë, ligji njih për herë të parë konceptin e **reduktimit të numrit të operatorëve ekonomikë të kualifikuar në procedurat me faza**, nëse një gjë e tillë përcaktohet si mundësi nga autoriteti kontraktor që në dokumentet e tenderit.
- Ulja e afatit minimal të periudhës së përjashtimit të operatorëve ekonomikë nga e drejta për të fituar kontrata publike, duke filluar nga 3 muaj;
- Parashikimi i periudhës së pritjes, gjatë së cilës autoriteti kontraktor nuk mund të nënshkruajë kontratë, periudhë e cila fillon nga shpallja e njoftimit të fituesit
- Ankimi i operatorëve ekonomikë, njëkohësisht si në autoritetin kontraktor, edhe në KPP, duke shkurtuar procesin e rishikimit administrativ i afateve të ankimit; Ankim për blerjet me vlerë të vogël
- Parashikimi për herë të parë i konceptit të modifikimit të kontratave, si dhe rasteve të pavlefshmërisë së kontratave.



Interpretimi i Nenit 2 (1) (5) të Direktivës 2014/24 dhe nocioni i "kontratave për interes monetar"

Refuzimi i ofertës së një tenderuesi me një çmim prej 0.00 EUR.

Çështja kryesore: nëse fakti i vetëm që marrja e kontratës publike është vetë me vlerë ekonomike për operatorin ekonomik mund të jetë i mjaftueshëm që kontrata të karakterizohet si një kontratë me interes pasuror?

Gjykata: Jo, por neni 2 (1) (5) nuk lejon refuzimin automatik të një tenderi të tillë.

Meqenëse një tender me një çmim prej 0.00 EUR mund të klasifikohet si një tender anomalisht i ulët në kuptimin e Nenit 69, kur një autoriteti kontraktues paraqitet me një tender të tillë, ai duhet të ndjekë procedurën e parashikuar në atë dispozitë dhe t'i kërkojë tenderuesit që të shpjegojë shumën e tenderit.

C-336/12 Manova

- Gjykata referuese i kërkoi GjD-së "nëse parimi i trajtimit të barabartë do të thoshte se, pas skadimit të afatit për aplikimet për të marrë pjesë në një procedurë të tenderimit, autoriteti kontraktues nuk mund t'i kërkonte një kandidati të dorëzonte një kopje më të fundit të bilancit të tij ... nëse kandidati nuk kishte dorëzuar dokumente të tilla së bashku me aplikimin e tij".
- Ndikimi në Shqipëri? N.92/3 - **Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.**



Bibliografi, materiale, dokumenta zyrtare dhe linke për konsultim të mëtejshëm mbi leksionin e sotëm (Reader)

- Bibliografi

- ✓ Strategjia kombëtare për prokurimin publik 2020-2023 - Raporti i Monitorimit Janar-Dhjetor 2022 (APP)

- Ligje, VKM, Dokumenta Zyrtare:

- ✓ VKM Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.
- ✓ VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public”.
- ✓ Direktiva 2014/24/BE e Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 26 shkurt 2014 “Për prokurimin publik dhe që shfuqizon Direktivën 2004/18/KE”, e ndryshuar”. Numri CELEX 32014L0024, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr.94, datë 28.3.2014, fq.65- 242.
- ✓ Direktiva 2014/25/BE e Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 26 shkurt 2014 “Për prokurimin nga entet që veprojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare dhe që shfuqizon Direktivën 2004/17/KE”, e ndryshuar”. Numri CELEX 32014L0025, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr.94, datë 28.3.2014, fq. 243-374.
- ✓ Direktiva e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989 “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike”, e ndryshuar”. Numri CELEX 31989L0665, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr.395, datë 30.12.1989, fq. 33-35.
- ✓ Direktiva e Këshillit 92/13/KEE, datë 25 shkurt 1992 “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e rregullave të Komunitetit për procedurat e prokurimit të enteve që operojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe telekomunikacionit”, e ndryshuar”. Numri CELEX 31992L0013, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr.76, datë 23.3.1992, fq. 14-20.

- Linke të dobishme

- [Agjencia e Prokurimit Publik - Rreth nesh \(app.gov.al\)](https://app.gov.al)
- European Commission (2021), Albania Report, pg. 60 https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2022_en

- ETJ.





With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



Faleminderit për vëmendjen!

Dr. Av. Artan Spahiu

artan.spahiu@arsimi.gov.al

